



RAPORTI I MONITORIMIT MBI GJUHËN E URREJTJES NË **SHQIPËRI**

2025

—

DORENTINA HYSA



Co-funded by
the European Union



Norway



SMART
Balkans
Civil Society for Shared Society
in the Western Balkans



Reporting
Diversity
Network

Autore: Dorentina Hysa

Ekspert i metodologjisë dhe redaktor: Stefan Janjić

Përktheu nga anglishtja në shqip: Esmeralda Cavo

Botues: Albanian Women in Audiovisual dhe Media Diversity Institute
Western Balkans



K2.0



“Rrjeti për Raportimin e Diversitetit” (Reporting Diversity Network-RDN) është themeluar nga “Media Diversity Institute”. Partnerët e projektit përfshijnë Media Diversity Institute, Western Balkans, Albanian Women in Audiovisual, Mediacentar Sarajevo, Kosovo 2.0, Qendrën për Gazetari Hulumtuese në Mal të Zi (Center for Investigative Journalism Montenegro), dhe Innovative Media.



Ky botim financohet nga Bashkimi Evropian dhe “SMART Balkans - “Shoqëria Civile për Shoqëri të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor”, projekt rajonal i zbatuar nga “Centar za promociju civilnog društva” (CPCD), “Center for Research and Policy Making” (CRPM) dhe “Institute for Democracy and Mediation” (IDM), dhe mbështetur financiarisht nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme (NMFA).

Përmbajtja e botimit është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron me doemos pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Ministrisë Norvegjeze të Punëve të Jashtme (NMFA), “Centar za promociju civilnog društva” (CPCD), “Center for Research and Policy Making” (CRPM) apo të “Institute for Democracy and Mediation” (IDM).



RAPORTI I MONITORIMIT MBI GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI 2025

DORENTINA HYSA

Përmbajtja

5	Hyrje
6	Qasja metodologjike
6	Mbledhja e të dhënave
7	Analiza e të dhënave
7	Kufizime
7	Narrativat dhe nënnarrativat e GJUD (Gjuhës së Urrejtjes dhe Diskriminimit)
7	Pasqyra e përgjithshme e GJUD në Shqipëri
8	GJUD mbi baza gjinore
11	GJUD ndaj gazetarëve
13	GJUD ndaj kundërshtarëve politikë
15	Analiza e qasjes emocionale
17	Analiza krahasuese
18	Masat e ndërmarra nga shteti kundër përdorimit të GJUD
19	Përfundime

Hyrje

Ky raport pasqyron situatën e Gjuhës së Urrejtjes dhe Diskriminimit (GJUD) në mjedisin mediatik shqiptar përmes analizës së shkallës së përhapjes, formave, ngjarjeve nxitëse dhe ashpërsisë së kësaj gjuhe bazuar në incidentet e raportuara dhe të mbledhura përmes raportimit mediatik.

Monitorimi mediatik është kryer nga **Albanian Woman in Audiovisual (AWA)** përgjatë periudhës kohore janar 2024–qershor 2025, duke përdorur të njëjtën metodologji sikurse në raportet e mëparshme. Gjatë periudhës së monitorimit u raportuan në total 96 incidente të përdorimit GJUD-së, të cilat iu nënshtruan analizës sasiore dhe cilësore të të dhënave.

Incidentet më të shpeshta të GJUD-së përgjatë periudhës së raportimit ishin ato me bazë gjinore me një përqindje prej (40.6%), ndaj gazetarëve me një përqindje prej (12.5%) dhe ndaj kundërshtarëve politikë me një përqindje prej (12.5%). GJUD-ja me baza gjinore mbetet një çështje shqetësuese dhe me shkallë të gjerë përhapjeje, ndërkohë që ajo ndaj gazetarëve dhe kundërshtarëve politikë është rritur ndjeshëm krahasuar me raportet e mëparshme. Një zhvillim pozitiv shënon ulja e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit ndaj minoriteteve seksuale, etnike dhe fetare.

Ngjarjet kryesore nxitëse, që bashkëlidhen me shtimin e përdorimit të GJUD-së ndaj gazetarëve dhe kundërshtarëve politikë ishin zgjedhjet parlamentare, të cilat u mbajtën në maj të vitit 2025, arrestimi i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, publikimi i artikujve investigativë, niveli i pavarësisë së medieve dhe llogaridhënia institucionale. Këto zhvillime kanë ndikuar në formësimin e tonit, shkallës së përhapjes dhe ndjeshmërisë ndaj GJUD-së.

Bazuar në raportin e vitit 2025 nga “Freedom House”, Shqipëria mbetet një vend “pjesërisht i lirë”, që përballlet me sfida të vazhdueshme në terrenin e pavarësisë së gjyqësorit, pluralizmit politik dhe atë të mbrojtjes së lirive civile. Në mënyrë të ngjashme, edhe organizata “Reporterë pa Kufij” (Reporters Without Borders) e [renditi](#) Shqipërinë në vendin e 99-të në vitin 2024 dhe në vendin e 80-të në vitin 2025 nga 180 vende, ku u krye monitorimi i lirisë së shtypit, duke vënë theksin te presioni politik ndaj medieve, te zbatimi i dobët i etikës profesionale nga gazetarët dhe kërcënimet në rritje ndaj gazetarëve investigativë.

Në një kontekst të atillë, mediat, të cilat shpesh janë të lidhura me interesat politikë apo tregtar, janë shndërruar jo vetëm në platforma, por edhe në përforcuese të GJUD-së. Është e një rëndësie të veçantë të përmendim valën e retorikës fyese gjatë fushatës zgjedhore, ku udhëheqësit politikë jo pak herë zëvendësuan debatin mbi politikën me fyerje personale dhe dehumanizimin simbolik. Ky fenomen përbën një tregues të një modeli më të gjerë, ku gjuha diskriminuese, dhuna dhe agresiviteti jo vetëm që po normalizohen, por po përforcohen në mediet tradicionale, në ato online dhe në shoqëri.



Qasja Metodologjike

Raporti ndjek një qasje metodologjike, që kombinon metodat kërkimore cilësore dhe sasiore. E njëjta metodologji është përdorur edhe në raportet e mëparshme të publikuara në vitin 2022 dhe 2023. Kjo metodologji mundëson një pasqyrë gjithëpërfshirëse të situatës aktuale të Gjuhës së Urrejtjes dhe Diskriminimit (GJUD) në Shqipëri, duke identifikuar prirjet, grupet kryesore të synuara, autorët e narrativave përçarëse dhe të urrejtjes, ashpërsinë e tyre, si dhe shkallën e shtrirjes tek audienca.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij raporti kërkimor monitorues është analiza e Gjuhës së Urrejtjes dhe Diskriminimit (GJUD) në mjedisin mediatik shqiptar gjatë periudhës janar 2024 – qershor 2025.

Objektivat e raportit kërkimor janë:

- Identifikimi i prirjeve kryesore të GJUD-së në diskursin publik në Shqipëri gjatë periudhës janar 2024-qershor 2025;
- Vlerësimi i ashpërsisë në përdorimin e GJUD-së përmes analizës së qasjes emocionale të narrativave dhe nënnarrativave, që kanë në fokus grupet më të prekura.

Mbledhja e të dhënave

Ky raport mbështetet tek të dhënat e mbledhura përgjatë periudhës së monitorimit janar 2024-qershor 2025. Monitorimi mediatik është kryer në mënyrë të përvajshme me qëllim për të identifikuar dhe raportuar rastet e përdorimit të GJUD-së, që lidhen me gjininë, përkatësinë etnike, fenë, minoritetet seksuale, emigrantë/refugjatë dhe kategori të tjera, duke iu dhënë mundësinë monitoruesve të regjistrojnë të gjitha incidentet e identifikuara. Në analizë janë përfshirë gjithsej 96 incidente.

Incidentet janë raportuar dhe regjistruar duke përdorur të njëjtin [instrument](#) si në vitet e mëparshme, i cili mbledh informacion mbi: datën e publikimit të incidentit, vendin ku ka ndodhur, llojin e urrejtjes së identifikuar, përmbajtjen/narrativën e diskursit, autorin ose autorët e incidentit, median ku është publikuar dhe shkallën e shtrirjes.

Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura i janë nënshtruar analizës sasiore dhe cilësore. Të dhënat sasiore janë koduar dhe analizuar nga programi SPSS përmes përdorimit të testimeve statistikore përshkruese (shpeshtësia dhe verifikimi i ndërsjellë i të dhënave) për të kuptuar prirjet kryesore të GJUD-së në Shqipëri gjatë periudhës së raportimit. Analiza cilësore përbëhet nga analiza narrative dhe/ose e nënnarrativave, analiza e qasjes emocionale, analiza krahasuese dhe e dukshmërisë, që së bashku sigurojnë një kuptim më të thelluar të narrativave.

Kufizimet

Të dhënat fillestare janë mbledhur përmes monitorimit mediatik, i cili është kryer nga dy monitorues në media. Si rezultat, identifikimi, raportimi dhe kategorizimi i incidenteve mund të jetë ndikuar nga vlerësimi subjektiv i secilit monitorues.

Për më tepër, pyetësi i raportimit të incidenteve, ndonëse është përdorur në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse, nuk mbulon të gjitha format e gjuhës së urrejtjes që shfaqen në media, gjë që vështirëson kategorizimin e saktë të disa rasteve të përdorimit të GJUD-së.

Numri i incidenteve të përfshira në këtë raport është relativisht i lartë. Ndonëse rastet i janë nënshtruar të gjitha analizës sasiore dhe cilësore, vetëm disa prej tyre janë përzgjedhur për të ilustruar narrativat. Analiza narrative është kryer vetëm për tri kategoritë mbizotëruese, duke mos përfshirë të gjitha kategoritë e GJUD-së.

Narrativat dhe nënnarrativat e GJUD

Pasqyrë e përgjithshme e përdorimit të GJUD-së në Shqipëri

Në këtë raport janë përfshirë incidentet e ndodhura gjatë periudhës janar 2024-qershor 2025. Gjatë kësaj periudhe janë raportuar 96 incidente gjithsej, 12 prej tyre janë klasifikuar në 12 kategori të ndryshme të GJUD-së, ndërsa 84 janë regjistruar në kategori të veçanta. Siç pasqyrohet edhe në Tabelën 1, narrativat më të përhapura të përdorimit të GJUD-së janë mbi baza gjinore me(40.6%), ndaj kundërshtarëve politikë me(12.5%) dhe ndaj gazetarëve me(12.5%). Përdorimi i GJUD-së mbi baza gjinore mbetet në të njëjtat nivele si në raportin e fundit, ndërkohë që narrativat kundër kundërshtarëve politikë dhe gazetarëve janë rritur ndjeshëm krahasuar me raportet më të hershme të viteve [2022](#)¹ dhe [2023](#)².

1. Në vitin 2022, GJUD me bazë gjinore ishte (20.5%), ndaj kundërshtarëve politikë (7.2%) dhe ndaj gazetarëve (2%)

2. Në vitin 2023, GJUD me bazë gjinore ishte (41%), ndaj kundërshtarëve politikë (Nuk ka të dhëna) dhe gazetarëve (2%)

Numri total i incidenteve: 96		Incidentet që bëjnë pjesë në disa kategori janë përjashtuar nga kategoritë e veçanta		Incidentet që bëjnë pjesë në disa kategori janë përfshirë në kategoritë e veçanta	
		N	Përqindja (%)	N	Përqindja (%)
Kategoritë e GJUD-së	Kundër gjinisë	39	40.6%	50	45.9%
	Kundër pakicave seksuale	6	6.3%	8	7.3%
	Kundër etnisë	3	3%	6	5.5%
	Kundër gazetarëve	12	12.5%	15	13.8%
	Kundër kundërshtarëve politikë	12	12.5%	16	14.7%
	Kundër institucioneve publike	4	4%	4	3.7%
	Kundër fëmijëve/minorenëve	3	3%	4	3.7%
	Kundër emigrantëve	1	1%	1	0.9%
	Kundër përkatësisë fetare	1	1%	2	1.8%
	Të tjera (Persona me aftësi të kufizuar, etj.)	3	3%	3	2.8%
Kategori të shumta		12	12.5%		
Totali		96	100%	109	100%

Tabela 1. Kategoritë e GJUD

Narrativat e tjera të Gjuhës së Urrejtës dhe Diskriminimit (GJUD) përfshijnë pakicat seksuale (7.3%) dhe përkatësinë etnike (5.5%), të cilat kanë shënuar një ulje të ndjeshme krahasuar me raportet e mëparshme. Gjatë periudhës së monitorimit janë identifikuar dy kategori të reja të GJUD-së, ato ndaj institucioneve publike (3.7%) dhe ndaj fëmijëve/minorenëve (3.7%). Ndërkaq, narrativat kundër fesë dhe emigrantëve/refugjatëve mbeten në nivele të ulëta.

Rezultatet e përhapjes së GJUD-së në kategoritë e ndryshme pasqyrojnë dhe lidhen ngushtësisht me ngjarjet socio-politike që zhvillohen në vend, përfshirë në mënyrë të veçantë zgjedhjet parlamentare të mbajtura në maj 2025, arrestimin dhe burgosjen e kryebashkiakut të Tiranës nga Gjkata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe problemet sociale në vazhdimësi (dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje, abuzimi/trafikimi seksual, ngacmimet, etj.).

GJUD mbi baza gjinore

Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit ka dominuar në mjedisin mediatik në Shqipëri edhe gjatë viteve 2024-2025, duke qëndruar në nivele të larta shqetësuese si në raportet e mëparshme. Narrativat me bazë gjinore shfaqen përmes sensacionalizmit, objektivizimit dhe retorikës seksiste, të prodhuara ose të amplifikuara nga media. Fakti që GJUD mbi baza gjinore mbetet forma më e përhapur tregon institucionalizimin e urrejtjes ndaj grave në një shoqëri patriarkale dhe mungesën e profesionalizmit mediatik për të raportuar me ndjeshmëri ndaj çështjeve sociale me bazë gjinore. Shkaku kryesor nxitës i GJUD-së kundër gjinisë është të qenit vajzë/grua apo djalë/burrë.

Dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje, abuzimi/shfrytëzimi seksual dhe ngacmimi janë probleme të vazhdueshme sociale. Megjithatë, incidentet tregojnë se raportimi mediatik mbi këto tema të ndjeshme bëhet përmes prizmit të sensacionalizmit, duke i dhënë përparësi argëtimit në vend të ndjeshmërisë, dhe shpesh duke shpërndarë emrat, fotot dhe detajet personale të viktimave, në shkelje të [Kodit të Etikës së Gazetarëve](#). Titujt “click-bait” (karrem për klikime) mbeten një instrument strategjik që media përdor për të përfutur sa më shumë klikime në artikujt e tyre pa marrë në konsideratë dëmin që shkaktojnë te personat e prekur, te familjet e tyre apo në tërësi në shoqëri.

Për shembull, vlen të përmendet [rasti](#) i 3 vajzave minorene (mosha 15, 16 dhe 17 vjeçe), të cilat ishin viktimat e shfrytëzimit seksual, një rast që u raportua në një sërë mediesh dhe portalesh. Ndërkohë që disa media treguan kujdes të veçantë në raportimin e rastit, duke u përqendruar tek arrestimi dhe eliminimi i rrjetit kriminal, disa të tjera përdorën tituj sensacionalë si: [“Prostitucion me të mitura në Tiranë”](#), [“3 adoleshente prostituonin në hotelet e Fushë-Krujës”](#), ose [“E ke gati në hotel”](#).

Një qasje e tillë raportimi, në vend që të trajtojë fenomenin e shfrytëzimit seksual për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështjen dhe të ofrojë gjithashtu një analizë më të thelluar, e zhvendos vëmendjen te rasti individual duke theksuar faktin se vajzat janë larguar nga shtëpia me vullnetin e tyre të plotë, kanë qëndruar në hotele dhe kanë marrë para prej punës së tyre, etj.

“3 të mitura u shfrytëzuan për prostitucion në zonën e Fushë-Krujës:
[Ne ikëm nga shtëpia me dëshirë.”](#)

Një tjetër [rasti](#) ngjashëm përfshin një mjek, i cili u akuzua nga autoritetet ligjore për trafikim të të miturve dhe pornografi. Media e raportoi rastin në mënyrë të atillë duke zhvendosur vëmendjen nga problemi thelbësor i trafikimit të minoreneve dhe pornografia te numri i bashkëshorteve të tij, duke e bashkëlidhur me çështje morali dhe fetare. Kjo qasje në raportim priret të justifikojë veprimet abuzuese të mjekut ndaj vajzës minorene duke normalizuar sjelljen, ndonëse masat ligjore janë të qarta për moshën e pëlqimit, e cila është mbi 14 vjeç.

“Haremi i Doktorit! Fe, manipulim apo ekstremizëm u
shndërruan në shkak abuzimi...!”

Në rastet e dhunës në familje, media ndjek të njëjtën qasje raportimi, sensacion mbi përgjegjësinë, dramë mbi analizën kritike e sistematike, por edhe shkelje të privatësisë. Për shembull, [rasti](#) i dy grave të vrara në Kosovë brenda pesë ditësh u raportua edhe nga mediet shqiptare, por fokusi u përqendrua tek identitetet dhe marrëdhëniet romantike të viktimave, në vend që të theksoheshin masat parandaluese apo llogaridhënia institucionale. Në mënyrë të ngjashme, [rasti](#) i dhunës në familje ndaj këngëtares së muzikës popullore, Maja, u shndërrua në histori shoubizi, në vend që të shërbente si platformë për mbështetje dhe ndërgjegjësim.

Ky lloj mbulimi i lajmit për dhunën në familje e normalizon dhunën, pengon viktimat të kërkojnë ndihmë kur lind nevoja dhe promovon durimin e dhunës nga ana e tyre. Narrativa të tilla mund të kenë pasoja shkatërruese, sikurse në [rastin](#) e aktore Rita Latë, e cila, sipas dëshmisë së vajzës së saj, ishte viktimë e dhunës në familje, por “e pranonte” situatën për shkak të presionit publik dhe shoqëror.

“Vajza tregon historinë tronditëse të Rita Latit: Babai e rrihte,
por ajo nuk iku sepse e quanin kurvë.”

Objektivizimi dhe seksualizimi i grave përbën një formë të përsëritur të diskriminimit të bazuar në gjini. Trupat femërorë përdoren shpesh si mjete marketingu, pa asnjë lidhje me produktin që promovohet, siç shihet në reklamën e [Lori Caffè](#), ku një modele e veshur me bikini përdoret për të promovuar një lloj kafeje apo në fushatën e [DigitAlb](#), ku gratë barazohen me mallra luksoze. Portretizime të tilla zvogëlojnë figurën e gruas në një objekt vizual dhe përforcojnë stereotipat gjinorë. Megjithatë Kodi i Rishikuar i Transmetimit përfshin një kapitull mbi Barazinë Gjinore dhe Seksizmin, situata vijon të mbetet e pandryshuar pasi mediet dhe gazetarët në mënyrë të përsëritur riprodhojnë stereotipa dhe seksizëm të bazuar në gjini.

Nga ana tjetër, gratë në politikë përballen me seksizëm të drejtpërdrejtë dhe të hapur, i cili rrezikon besueshmërinë e tyre profesionale. Politikanë dhe figura publike përdorin fyerje të bazuara në gjini, kritika mbi pamjen e jashtme dhe metafora të rrënjësura në normat patriarkale. Për shembull, deputeti Edmond Spaho i tha një kolegeje se “dukej e aq egër, sikur sapo e kishin rrahur”, ndërsa një gazetar bëri një [komment](#) lidhur me rezultatet e zgjedhjeve, duke u shprehur se “një lopë mori më shumë vota se Jorida!”. Përdorimi i një gjuhe të tillë përforcon stereotipin se gratë nuk janë të përshtatshme në politikë apo në role drejtuese.

“Dukesh e egër, sikur sapo të kanë rrahur. Të ka ndodhur gjë? Na e thuaj, që të të mbështesim,”

“Një lopë mori më shumë vota se Jorida!”

Gjuha e urrejtjes online ndaj grave dhe vajzave po shndërrohet në një formë domethënëse dhe të përsëritur të GJUD-së në hapësirat digjitale. Kjo formë vë shpesh në shënjestër gratë në politikë, gazetari dhe profesione me dukshmëri të lartë, ku sulmet nuk janë të kufizuara veç në forma të kritikës profesionale, por kapërcejnë jetën personale dhe familjare. Këto sulme online nuk përbëjnë incidente të izoluara. Shpesh shfaqen si fushata të koordinuara ngacmimesh, të nxitura nga daljet publike të grave në media, deklaratat politike, ose rolet publike të tyre.

Për shembull, [rasti](#) i Majlinda Bregut, Sekretare e Përgjithshme e “RCC”, e cila pas një interviste në emisionin “Opinion”, u bë shënjestër e shumë komenteve fyese dhe seksiste. Komentet prekën pozicionet e saj politike, por edhe gjininë, pamjen dhe familjarët e saj, duke vënë në dukje se besueshmëria e grave sulmohet përmes poshtërimit, jo përmes debatit substancial.

“Je gruaja më e korruptuar nga të gjitha gratë shqiptare në politikë;
je një plehrë dhe një grua me 500 fytyra.”

Autorët kryesorë të përdorimit të GJUD-së me baza gjinore janë gazetarët dhe punonjësit e medieve, të cilët ose e shprehin, lejojnë apo riprodhojnë narrativa të dëmshme. Influencuesit, bloggerët dhe personazhet e famshme përbëjnë një tjetër kategori që prodhon GJUD, të pasuar nga politikanë/zyrtarë shtetërorë dhe persona privatë (përdorues të rrjeteve sociale).

Analiza e dukshmërisë tregon se incidentet kanë ndodhur kryesisht në televizione, dhe më pas janë përhapur në portale online dhe në profilet e rrjeteve sociale të medieve. Shkalla e shtrirjes nis nga 1.000 deri në 300.000 shikime, në varësi të incidentit, grupit të synuar, kanalit mediatik dhe titullit të postimeve/artikujve. Përmbajtjet që riprodhojnë GJUD në tituj zakonisht kanë shtrirje më të madhe, më shumë ndërveprim dhe shpërndarje në rrjete sociale.

Përdorimi i GJUD-së ndaj gazetarëve

Ndryshe nga raportet e mëparshme, përdorimi i GJUD-së kundër gazetarëve dhe medias ka shënuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve 2024–2025. Po aq shqetësues sa rritja e shifrave është edhe natyra e incidenteve, ku përfshihet përhapja e gënjeshtreve të dëmshme, dezinformimi dhe keqinformimi; sulmet kibernetike, kërcënime dhe deklarata që në mënyrë potenciale rrezikojnë sigurinë, si dhe padi penale dhe fyerje kundër gazetarëve. Incidentet e raportuara tregojnë se gazetarët profesionistë dhe mediat cilësore janë shënjestra kryesore e GJUD, e cila gjenerohet nga politikanë, zyrtarë shtetërorë dhe media të tjera me lidhje politike.

Shënjestra e GJUD kanë qenë si gazetarë burra, ashtu edhe gra, veçanërisht ata që mbulojnë tema të gazetarisë investigative, si korrupsioni në nivele të larta, abuzimi me fondet publike, dhe zbulimi i shkeljeve nga individë në pushtet. Ngjarjet kryesore që nxisin GJUD ndaj gazetarëve lidhen me publikimin e përmbajtjeve investigative ose kritike, që zbulojnë skema korrupsioni, shkelje të ligjit dhe abuzim me pushtetin, duke etiketuar politikanë përgjegjës dhe institucione publike.

Për shembull, një media e pavarur, “Citizens Channel”, u shndërrua në shënjestrën e një sulmi kibernetik në prill të vitit 2024, ku përmbajtja e saj në rrjete sociale u fshi, ndërsa faqja e internetit u bllokua. Këshilli i Evropës publikoi një [“alarm” të nivelit 2](#) për këtë sulm, duke theksuar se ndalimi ndodhi pas raportimeve mbi “çështje me interes publik, përfshirë ndërtimin e Teatrit Kombëtar dhe dhënien e lejeve për ndërtimin e rrokaqiejve nga Bashkia e Tiranës, ku kjo media zbuloi se kompanitë ndërtuese po zinin toka publike pa paguar taksa. Përmbajtje të tjera që u fshinë lidhen me rezistencën e komuniteteve në Thirrë dhe Zall-Gjocaj ndaj abuzimit me burimet natyrore.”

Një rast tjetër i ngjashëm kishte në shënjestër [Media Look](#), e cila sulmohej prej disa muajsh, derisa në qershor 2024, profili në Facebook i menaxherit të saj, Elvin Luku, u mbyll, duke bërë të pamundur qasjen në faqet e medias në rrjete sociale. [Sipas Media Look](#), “Koha dhe natyra e përmbajtjeve të publikuara sugjerojnë se sulmet mund të kenë qenë një reagim ndaj qëndrimit kritik të “Media Look” për dezinformimin dhe llogaridhënien qeveritare.” Disa medie dhe grupe gazetarësh reagueshan dhe dënuan këto sulme, përfshirë si në vijim: Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (Safe Journalists’ Network), [Reporter.al](#), [Citizens.al](#), Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dhe Shoqata e Gazetarëve Shqiptarë.

Ky sulm i drejtpërdrejtë ndaj medieve cilësore përbën një hap mbrapa në lirinë e shtypit dhe frikëson praninë e zërave kritikë në media. Nga ana tjetër, dëmton praninë digjitale, shtrirjen dhe marrëdhënien me publikun, që këto media kanë ndërtuar ndër vite, duke shkaktuar konfuzion publik dhe vështirësuar dallimin mes fakteve dhe propagandës/dezinformimit.

Numërohen gjithashtu edhe raste të tjera të përdorimit të GJUD-së dhe sulmeve kundër gazetarëve, në formën e poshtërimeve publike dhe shpifjeve, veçanërisht ndaj grave gazetare. Një rast i tillë është ai i gazetares investigative Ola Xama, e cila ka qenë shënjestër e kërcënimeve të vazhdueshme dhe fushatave shpifëse për shkak të raportimeve të saj mbi skandalin e inceneratorit të Tiranës, që përfshin kryetarin e bashkisë Erion Veliaj. Puna e saj investigative zbuloi parregullsi, përfshirë akuza për korrupsion të lidhura me kryetarin dhe familjen e tij. Pas raportimeve, ajo është përballur me sulme nga media me lidhje politike. Një [artikull](#) i publikuar e akuzonte se ishte “gazetare e paguar” dhe “vrasëse me pagesë”, madje përshkallëzoi me publikimin e adresës së saj private dhe sulmin ndaj familjes së saj.

“Gazetarja Ola Xama mori para nga qeveria, Bashkia e Tiranës dhe kompania e inceneratorit përmes bashkëshortit të saj, Ilir Pandeli. Në momentin që pagesat u ndërpre, ajo filloi të ‘denoncojë’ korrupsionin nëpër panele televizive!”

I njëjti portal online vuri në shënjestër edhe Blerjana Binon, duke e akuzuar se kishte shkruar një raport të njëanshëm mbi lirinë e medias, në favor të ish-kryeministrit Sali Berisha. Sulmi u nxit nga publikimi i raportit [“Media Freedom in Albania: a Shadow Report”](#), i publikuar nga SciDev dhe Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa. Ky [raport fokusohej](#) në seksionin e tretë të Raportit të Komisionit të BE-së për Shtetin Ligjor 2024, kushtuar lirisë dhe pluralizmit të medias, me qëllim ofrimin e një analize të përditësuar të peizazhit mediatik shqiptar, përfshirë sfidat ekzistuese dhe ato në zhvillim.

“Merimanga” e fondeve të shoqërisë civile, Blerjana Bino,
raporte të njëanshme mbi sulmet ndaj gazetarëve.”

Disa raste të tjera që lidhen me përdorimin e GJUD-së ndaj gazetarëve përfshijnë zyrtarë shtetërorë dhe figura publike. Për shembull, [rasti](#) i Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ndaj një gazetareshe dhe motrës së saj, pas raportimit mbi dështimin e Ministrisë për të administruar vaksinën kundër brucelozës, një projekt me kosto 1.7 milionë euro që përbën një çështje kritike, që prek shëndetin publik dhe bujqësinë; ose [rasti](#) i Kryeministrit Edi Rama kur një gazetarë e pyeti lidhur me projektin e investimit të Jared Kushner (dhëndri i Donald Trump) gjatë një konference për shtyp, kjo e fundit u përball me frikësim.

Për më tepër, vlen të përmendet edhe [rasti](#) i një notereje, që sulmoi fizikisht gazetaren dhe ekipin e xhirimit, duke i mbajtur me forcë, pasi ajo kishte raportuar për shkelje ligjore nga noterja.

“O unë, o ti në këtë botë.”

Ka edhe raste të tjera të ngjashme, që përfshijnë Policinë e Shtetit, deputetë dhe zyrtarë të tjerë publikë. Megjithatë një pjesë e madhe e incidenteve përfshin përdorimin e GJUD-së të prodhuar nga zyrtarë publikë, ka edhe raste që përfshijnë publikun online ose qytetarët. Për shembull, gazetari sportiv [Ervin Baku](#) u bë objekt i gjuhës së urrejtjes në masë, sepse gjatë një komenti për kampionatin shqiptar, ai mbante një bluzë të ekipit të volejbollit nga Serbia.

“Qen pa atdhe. Ushqehet me taksat tona dhe luan me dinjitetin tonë.
Ky ndyrësira ka nevojë për një mësim të mirë që të mos shkelë më në Shqipëri.”

“Burgim i përjetshëm... sepse Shqipëria nuk ka dënim me vdekje.
Familja e tij duhet dëbuar.”

Ndërsa një gazetarë tjetër u bë objekt fyerjesh dhe sulmesh nga një qytetar gjatë një proteste në mbështetje të ish-kryeministrit Sali Berisha. Gazetarja dhe ekipi i saj u sulmuan fizikisht dhe verbalisht. Ajo u etiketua si “kukull” dhe “propagandiste.”

Analiza e dukshmërisë tregon se incidentet kanë ndodhur njësoj në televizione, portale online (revista) dhe rrjete sociale. Mënyrat e shpërndarjes tregojnë polarizimin e medias dhe përdorimin e saj sipas lidhjeve politike. Shkalla e shtrirjes së këtyre incidenteve është e lartë, duke arritur deri në 300.000 persona në rrjetet sociale, duke marrë parasysh se të dhënat për shkallën e shtrirjes së televizioneve dhe portaleve online nuk janë publike.

Megjithatë, siç u përmend në disa raste, veçanërisht në sulmet ndaj gazetarëve, sulmet kibernetike, fushatat e shpifjeve, në kërcënimet fizike dhe verbale, media në përgjithësi ka treguar mbulim selektiv ose mungesë mbulimi. Ky fenomen pasqyron lidhjet politike ose presionet që komprometojnë integritetin gazetaresk dhe rolin e medias si mbikëqyrëse e demokracisë.

Përdorimi i GJUD-së ndaj kundërshtarëve politikë

Përdorimi i GJUD-së ndaj kundërshtarëve politikë është rritur me 5% gjatë periudhës 2024–2025, krahasuar me raportin e vitit [2022](#). Megjithatë GJUD-ja e gjeneruar nga dhe kundër kundërshtarëve politikë dhe grave në politikë ka qenë gjithmonë e pranishme në mjedisin mediatik shqiptar, gjatë kësaj periudhe ajo është intensifikuar.

Incidentet përfshijnë shumë kategori të GJUD-së, duke përfshirë: gjuhë urrejtjeje, seksizëm dhe stereotipa gjinorë, nxitje dhune, dehumanizim, aluzione homofobike, dhe dezinformim të motivuar politikisht. Këto të fundit janë kryer nga figura politike, më shpesh nga persona në pozita pushteti, si edhe nga media, drejtpërdrejt ose përmes amplifikimit. Ngjarjet kryesore që kanë nxitur përdorimin e GJUD-së kundër kundërshtarëve politikë kanë qenë zgjedhjet parlamentare, arrestimi i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe zhvillimet e tjera politike në vazhdimësi.

Më 11 maj 2025, në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet parlamentare. Partia Socialiste, që kishte qenë në pushtet për tri mandate radhazi, luftoi fuqishëm për ta mbajtur pushtetin, ndërsa opozita, e përfaqësuar zyrtarisht nga Partia Demokratike, luftoi për ta marrë atë. Fushatat elektorale të këtyre dy partive kryesore, në vend që të përqendroheshin në paraqitjen e planeve strategjike për elektoratin, u përqendruan në denigrimin e kundërshtarëve, duke përdorur gjuhë urrejtjeje, tallje dhe dehumanizim.

Dehumanizim simbolik i tepruar u përdor gjatë fushatës nga kryeministri Edi Rama, njëherazi edhe Kryetar i Partisë Socialiste, kundër kundërshtarëve të Partisë Demokratike. Për shembull, gjatë gjithë fushatës ai iu referua udhëheqësit të opozitës, Sali Berisha, si “bufi i moçalit”, një metaforë e krijuar për ta tallur dhe për ta paraqitur si të tjetërsuar. Kjo frazë e portretizon Berishën jo si aktor politik, por si një krijesë të lidhur me kalbëzimin dhe errësirën. Kjo taktikë retorike e ul figurën e kundërshtarit në formën e një karikaturë shtazore, në vend që të merret me argumentet e tij politike.

Si kundërpërgjigje ndaj këtij dehumanizimi simbolik, këshilltari strategjik i fushatës së opozitës Chris LaCivita publikoi më vonë një imazh të një bufi që kap një mi, duke nënkuptuar Ramën si prenjë. Ky reagim shfaq më së miri se si retorika e Partisë Socialiste ndihmoi në krijimin e një fushate të bazuar në dehumanizim të ndërsjellë, në vend të debatit mbi politikën.

U përdorën gjithashtu edhe metafora jo fizike, tallje për pamjen fizike, ulje të figurës profesionale ose krahasime me persona me aftësi të kufizuara me qëllim për të përbuzur kundërshtarët politikë. Disa shembuj të një diskursi të tillë janë: “vazo arkeologjike”, “vazo e padobishme”, “autik”, “ka vida mangët”, etj. Narrativa të tilla sugjerojnë pavlefshmëri, brishtësi dhe anakronizëm. Duke e paraqitur kundërshtarin si objekt statik e dekorativ, autori nënkupton se ai nuk ka rol funksional në politikë dhe i përket së kaluarës, duke zbehur rëndësinë e tij në proceset demokratike aktuale.

“As kontrollor biletash nuk do ta bëja.”

Dhuna fizike dhe verbale është një tjetër formë e përsëritur e përdorimit të GJUD-së në debatet parlamentare dhe televizive. Për shembull, deputeti i opozitës Flamur Noka është përfshirë në një sërë incidentesh duke penguar fizikisht kolegët të flasin, duke hedhur një shishe uji ndaj ministrit Taulant Balla, madje edhe duke kryer gjeste vulgare me dorë ndaj kundërshtarëve politikë. Përmendim rastin kur gjatë një debati të nxehtë parlamentar, ai kërcënoi:

“Do t’ju hidhemi në fyt si mace... do ta shihni shumë shpejt Parlamentin në flakë.”

Në mënyrë të ngjashme, edhe në emisionin televiziv “360 Gradë”, Laert Vasili e përshkallëzoi debatin verbal me Marin Sulin në një akt dhune fizike, duke hedhur një shishe uji drejt tij, ndërsa shoqëroi veprimin me fyerje si: “Ti je ajo motra, që ia shite prapanicën Omonias.” Mungesa e ndërhyrjes nga moderatori, si dhe sondazhet e mëvonshme të medieve, që u kërkonin shikuesve të gjykonin nëse agresori kishte të drejtë, tregojnë se si mediet në disa raste e banalizojnë apo e shndërrojnë në lojë sjelljen e dhunshme.

Transmetimi i këtyre akteve të dhunshme nga media, mungesa e ndërhyrjes nga ana e moderatorëve, si dhe përforcimi i narrativave përmes vendosjes në tituj të fjalëve të sakta të përdorura, kontribuojnë në normalizimin e dhunës dhe në degradimin e diskursit politik.

Seksizmi dhe stereotipat gjinorë ishin gjithashtu të përhapura në media ose u amplifikuan përmes saj. Për shembull, Zegjine Çausi, kandidate e Partisë Socialiste, përdori insinuata seksiste dhe homofobike si armë politike kundër kundërshtarit të saj, Gazmend Bardhi. Për më tepër, ajo e talli duke iu referuar me nofkën “Gazi i Zegjinesë”, një emërtim i feminizuar që nënkupton nënshtrim apo zhburrërim.

“Je shumë i shtrembër, një balerin që di vetëm të tundet”

Nga ana tjetër, mediat dhe gazetarët gjatë raportimeve për gratë në politikë, priren të përqendrohen te paraqitja e tyre fizike, pamja apo aspekti emocional si gra, duke e lidhur kontributin e tyre në politikë më shumë me dukjen sesa me efikasitetin në punë. Për shembull, një koment publik: “*Do ta zhvishja Spiropalin. Duket shumë mirë.*” është tregues i qartë i seksualizimit dhe mungesës së vlerësimit të rolit politik të grave.

Analiza e dukshmërisë tregon se këto incidente janë shfaqur kryesisht në televizion, të ndjekura nga portalet online, rrjetet sociale (Facebook, Instagram, TikTok) dhe platforma YouTube. Përhapja e këtyre rasteve është e konsiderueshme, duke arritur deri në 200,000 persona vetëm në rrjetet sociale, ndërkohë që shifrat mbi shikueshmërinë në televizione dhe portale online nuk janë të disponueshme publikisht.



Analiza e qasjes emocionale

Analiza e qasjes emocionale për të gjitha rastet tregon një nivel të moderuar ashpërsie, me një rezultat mesatar prej 2.96, çka nënvizon karakterin negativ të përmbajtjes. Pjesa më e madhe e incidenteve morën një vlerësim në nivelin 3 (46.9%), të ndjekura nga rastet me vlerësim në nivelin 2 (26%) dhe ato me vlerësim në nivelin 5 (12.5%). Për t'u vlerësuar pozitivisht mbetet fakti se asnjë rast nuk arriti nivelin maksimal 6. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kujdesshëm të rasteve, u identifikuan dy raste ku përmes gjuhës së përdorur nënkuptohej në mënyrë të tërthortë kërcënimi me vdekje apo cenimi i jetës.

		Frekuenca	Përqindja
Të vlefshme	1-Mospajtim	6	6.3%
	2-Veprime negative	25	26 %
	3-Karakter negativ	45	46.9%
	4-Demonizim/Dehumanizim	8	8.3%
	5-Dhunë	12	12.5%
	6-Vdekje	0	0
	Totali	96	100.0

Për të kuptuar shkallën e ashpërsisë së narrativave të GJUD-së në tri kategoritë më të përhapura, u krye një analizë specifike e qasjes emocionale për secilën kategori: GJUD mbi bazë gjinore, ndaj gazetarëve dhe ndaj kundërshtarëve politikë.

Mesatarja e rezultateve për përdorimin e GJUD-së mbi bazë gjinore ishte **3**, duke treguar një nivel të moderuar të përfshirjes emocionale, e përbërë kryesisht nga narrativa negative, por jo të dhunshme. Llojet më të përhapura të përmbajtjes përfshinin fyerje, etiketime negative, stereotipa dhe keqpërdorim të të dhënave personale.

Niveli	GJUD mbi baza gjinore
1. Mospajtim	Nuk ka gra të vështira, ka vetëm burra të paaftë t'i manipulojnë ato. Nuk ka gra të vështira, ka vetëm gra që nuk pinë alkool.
2. Veprime ngative	Përdorimi i imazhit të viktimës, zbulimi i identitetit të saj, dhe publikimi i fotos me fytyrën e pambuluar; zënka "vulgaritet", pishina, vajza, një formulë e përsëritur në të ashtuquajturat "programe verore"; Erion, je rritur dhe goja jote ha shumë m*t; "Zhduku, ik mbushu ."
3. Karakter negativ	Gruaja fut shejtanin në shishe; gruarë; prostituta; përdhunimi nënkupton vullnet. Nëse ajo nuk do, atëherë "po", përdhunoje, se vjen një moment dhe ajo gjen kënaqësi nga përdhunuesi. Por sa mbaron, shkon dhe të denoncon;
4. Demonizimi dhe dehumanizimi	Humori është privilegj i inteligjentëve, s'ma do mendja se gratë kanë kapacitetin të shkruajnë humor; dyshoj se gratë mund të shkruajnë skenarë; një lopë që merr më shumë vota sesa Jorida.
5. Dhunë	"Mos ma përmend më emrin mua", Erika gjuan me shuplakë Buçin pas takimit "të nxehtë" me Klaudian.
6. Vdekje	-

Mesatarja e rezultateve të përdorimit të GJUD-së ndaj gazetarëve është 3.5, duke treguar një nivel qasjeje emocionale nga i moderuar në të lartë. Ky rezultat nënkupton se ndaj gazetarëve shfaqen të gjitha nivelet e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, megjithatë, rreth 1/3 e incidenteve klasifikohen në nivelin 5-nxjtje e dhunës. Shqetësim më të madh përbën fakti se incidentet në nivelin 5 përfshijnë zyrtarë publikë, funksionarë shtetërorë dhe/ose politikanë, çka krijon terren që GJUD-ja të shndërrohet në veprim konkret në jetën reale dhe të ketë pasojë të drejtpërdrejta për gazetarët dhe/ose median. Kjo është dukshëm më e rrezikshme krahasuar me rastet e gjuhës së urrejtjes që vijnë nga qytetarët në hapësirat online.

Niveli	Përdorimi i GJUD-së ndaj gazetarëve
1. Mospajtim	Ajo ka nevojë për një burrë që të menaxhojë RTSH-në
2. Veprime negative	Sot humb të drejtën që të marrësh përgjigje nga unë [në një konferencë për shtyp] për 60 ditët në vijim. Do të të dërgojmë në një qendër riedukimi.
3. Karakter negativ	Gazetare e paguar, vrasëse me pagesë; Frëngji (vrime e ngushtë në muret e kështjellave për armët); përdoret për të përshkruar BIRN si agresor në vend të një entiteti gazetaresk të pavarur; një idiote e niveleve të larta; nuk është zonjë, por transgjimore.
4. Demonizim dhe dehumanizim	Qen, kanale të ujërave të zeza; përdorimi i fotos së një majmuni për të ilustruar një gazetar; qen pa atdhe; fajin më të madh e ka ai gazetari kokë-penis që e mori në intervistë dhe atë TV bordello që s'e ndërpreu transmetimin; "merimangë" e fondeve të shoqërisë civile.
5. Dhunë	Të dënohet me burgim të përjetshëm... sepse Shqipëria s'e ka dënimin me vdekje; familja duhet t'i deportohet. Ky ndyrësira ka nevojë për një mësim të mirë, që të mos shkelë më në Shqipëri.
6. Vdekje	Këta duhet të shpallen "non grata" ose të hidhen në turrën e druve; "O unë, o ti në këtë botë."

Mesatarja e vlerësimit të përdorimit të GJUD-së ndaj kundërshtarëve politikë është 3, çka tregon një qasje të moderuar emocionale, e cila përfshin retorikë me karakterizime dhe fyerje jo të dhunshme. Megjithatë me një ashpërsi të moderuar, këto narrativa ndikojnë në normalizimin e dhunës në diskursin publik dhe politik, duke nxitur agresivitetin në politikë si mjetin e vetëm për të arritur suksesin.

Niveli	Përdorimi i GJUD-së ndaj kundërshtarëve politikë
1. Mospajtim	Prapë u ktheve ti? Do të bësh edhe ca miliona euro të tjera që të mbyllësh ndonjë vrimë të vogël? Je një nga gratë shqiptare më të korruptuara në politikë; je një plehrë me 500 fytyra; për të ardhur keq që kjo grua sillet si palaço cirku, si palaçoja mbretit..."; Ç'janë këta palaço që vijnë në Shqipëri?
2. Veprime negative	Votoni PD... Le të asgjësojmë minjtë nga kanalet e ujërave të zeza dhe të spastrojmë shtëpinë. Motër, ule zërin; ti je turpi i shtetit shqiptar, jot bijë do të paguajë për veprimet e tua, sepse ke shfrytëzuar të varfrit; Ne, ne të pestë, gishtin do t'ju tregojmë. Noka, ti je shkëmb."
3. Karakter negativ	Sillesh si truprojtë e Gadafit, lëvdon udhëheqësin pa pikë dyshimi; racë e ndyrë. Ata si puna jote janë akoma më keq sesa ti; je një njeri i shtrembër, që tundesh si balerinë.
4. Demonizimi dhe dehumanizimi	Vazo arkeologjike; vazo e padobishme; buf që ka vlarë njerëz me kthetrat e veta, jo vetëm një herë, por disa herë dhe s'ke treguar pikë dhembshurie.
5. Dhuna	Do t'ju hidhemi në fut si mace; mos më provoko, se ke për ta parë shumë shpejt parlamentin në flakë, dhe jo vetëm parlamentin.
6. Vdekje	-

Analiza krahasuese

Ky raport bazohet në incidentet e përdorimit të GJUD-së të regjistruara ose të shpërndara përmes medieve gjatë periudhës 2024–2025. Objektivi i këtyre incidenteve kanë qenë grupe të ndryshme shoqërore, përfshirë gratë, gazetarët, kundërshtarët politikë, të miturit, institucionet publike, pakicat seksuale dhe kategori të tjera. Analiza narrative mundëson krahasimin mes kategorive të GJUD-së, duke evidentuar elemente të përbashkëta dhe veçori të veçanta.

Së pari, një tipar i përsëritur është personalizimi i diskursit, ku shpërqendrimi nga çështjet me përmbajtje thelbësore orientohet drejt sulmeve “ad hominem” përfshirë jetën private, pamjen fizike apo aspekte të tjera private jo relevante. Diskursi karakterizohet nga fyerje, etiketime negative dhe dhunë verbale.

Së dyti, GJUD amplifikohet shpesh nëpërmjet titujve televizivë, portaleve online dhe rrjeteve sociale, duke zgjeruar shtrirjen dhe ndikimin e tyre. Pavarësisht nëse burimi janë aktorë politikë, zyrtarë publikë, gazetarë/media apo përdorues online, narrativat e dëmshme përforcohen nga media. Postimet dhe titujt që riprodhojnë GJUD, shpesh fjalë për fjalë, priren të kenë më shumë ndërveprim, duke nxitur mediat të vazhdojnë me këtë lloj retorike për të siguruar shikueshmëri dhe vëmendje.

Së treti, në të gjitha kategoritë vërehet përsëritja e fyerjeve, stereotipave dhe metaforave dehumanizuese, të cilat kontribuojnë në normalizimin e sulmeve dhe armiqësisë në diskursin publik dhe politik. Këto shprehje manifestohen si në formë verbale, ashtu edhe joverbale (përmes imazheve, fotove apo memeve).

Ndërkaq, dallimet mes kategorive lidhen kryesisht me ngjarjet nxitëse, që ndikojnë në shfaqjen e GJUD-së. Për shembull, përdorimi i GJUD-së me bazë gjinore është i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme në media dhe u stimulua vetëm mbi bazën e dallimeve gjinore, ndërkohë që GJUD-ja ndaj kundërshtarëve politikë dhe gazetarëve ndikohet nga zhvillimet e momentit, siç janë zgjedhjet parlamentare apo arrestimet e zyrtarëve publikë.

Një tjetër dallim i rëndësishëm ka të bëjë me autorësinë e përdorimit të GJUD-së sipas kategorive. Gazetarët dhe mediat dominojnë në prodhimin e GJUD-së kundër grave, të miturve/fëmijëve dhe pakicave seksuale, ndërsa politikanët, zyrtarët shtetërorë dhe figurat publike dominojnë në përdorimin e GJUD-së drejtuar ndaj gazetarëve dhe kundërshtarëve politikë.

Lloji i përmbajtjes ose veprimit të përdorur ndaj secilës kategori ndryshon. GJUD-ja me bazë gjinore bazohet kryesisht në objektivizim, seksizëm, fajësim të viktimës dhe sensacionalizëm, shpeshherë e nxitur vetëm nga përkatësia gjinore e shënjestrës. Nga ana tjetër, GJUD-ja ndaj gazetarëve shpesh merr formën e fushatave të koordinuara, sulmeve kibernetike ose presioneve ligjore, me synimin për të rrezikuar besueshmërinë profesionale dhe për të kufizuar lirinë e medias.

Dhe në fund, GJUD-ja ndaj kundërshtarëve politikë tregon nivelin më të lartë të dehumanizimit simbolik dhe agresionit teatral, duke u përdorur kryesisht si mjet strategjik për mobilizimin e mbështetësve dhe jo për adresimin e çështjeve të politikave publike.

Masat e ndërmarra nga shteti kundër përdorimit të GJUD-së

Masat e ndërmarra nga shteti kundër përdorimit të GJUD-së krahasuar me raportet e mëparshme mbeten të pakta në numër si në këndvështrimin e efikasitetit, por edhe të ndikimit. Megjithatë, puna e disa aktorëve nuk mund të zbehet për shkak të kësaj arsyeje.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijon të trajtojë ankesat dhe të zhvillojë fushata ndërgjegjëse mbi diskriminimin, por ndërhyrjet mbeten kryesisht reaktive, me mungesë të theksuar të monitorimit pro aktiv. Autoriteti i Mediave Audiovizuale (AMA) zbaton dispozitat e Kodit të Transmetimit në lidhje me barazinë gjinore dhe gjuhën e urrejtjes, duke dhënë paralajmërime dhe gjoba në disa raste. Megjithatë, vazhdimësia e raportimeve seksiste dhe sensacionaliste, veçanërisht në televizion, tregon se masat zbatuese nuk funksionojnë mjaftueshëm si mekanizëm parandalues.

Ndërkaq, shoqëria civile ka luajtur një rol me dukshmëri më të lartë gjatë kësaj periudhe. Organizata të tilla si Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt (SJN), BIRN Albania dhe Unioni i Gazetarëve Shqiptarë kanë dënuar publikisht sulmet ndaj gazetarëve dhe kanë ofruar trajnime për sigurinë e profesionistëve të medias. Organizatat e fokusuara në çështjet gjinore kanë zhvilluar fushata kundër fajësimit të viktimave dhe seksizmit, ndërsa platforma verifikimi si Faktoje dhe Citizen Channel kanë monitoruar në mënyrë aktive diskursin politik duke nxjerrë në pah dezinformimin, veçanërisht gjatë zgjedhjeve të vitit 2025.

Një zhvillim pozitiv gjatë kësaj periudhe ka shënuar miratimi i [Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale](#), i cili synon të harmonizojë kuadrin ligjor të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet përfshirjes së Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Ky ligj përcakton rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe synon garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, në veçanti të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale. Edhe pse nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me gjuhën e urrejtjes, ligji parashikon mbrojtjen e të dhënave personale si përkatësia etnike, feja, orientimi seksual dhe bindjet politike, kategori të cilat shpesh ekspozohen pa autorizim nga media dhe gazetarët.

Përfundime

Ky raport bazohet në 96 incidente të përdorimit të GJUD-së me bazë gjinore, ndaj gazetarëve, ndaj kundërshtarëve politikë, fëmijëve/të miturve, pakicave seksuale dhe institucioneve publike, të ndodhura gjatë periudhës 2024–2025 në mediet tradicionale (televizion, radio, gazeta), në mediet digjitale (portale lajmesh, revista online) dhe rrjetet sociale (Facebook, Instagram, TikTok) në Shqipëri.

Tri kategoritë më të prekura nga gjuha e urrejtjes dhe diskursi diskriminues ishin: gjinia (40.6%), gazetarët (12.5%) dhe kundërshtarët politikë (12.5%).

Analiza e qasjes emocionale tregon se, megjithëse GJUD-ja është e përhapur në Shqipëri, ajo mbetet në nivele të moderuara intensiteti. Vlera mesatare e të gjitha incidenteve ishte 2.96, duke treguar një karakter negativ, të shoqëruar kryesisht me retorikë jo të dhunshme dhe fyerje. Shumica e incidenteve u klasifikuan në nivelin 3 të intensitetit (46.9%), të ndjekura nga niveli 2 (26%) dhe niveli 5 (12.5%). Megjithatë, ky fenomen nuk minimizon ndikimin negativ që këto narrativa përçarëse kanë mbi individët e vënë në shënjestër dhe mbi shoqërinë në tërësi.

Raportimi mbi dhunën me bazë gjinore dhe shfrytëzimin seksual shpesh i jep përparësi aspektit argëtues në vend të etikës profesionale. Raste si ai i shfrytëzimit seksual të tri vajzave të mitura janë trajtuar në mënyrë sensacionaliste, duke zhvendosur vëmendjen drejt zgjedhjeve të viktimave, në vend që të adresohen dështimet sistemike. Objektivizimi, fajësimi i viktimës dhe gjuha seksiste janë të normalizuara në diskursin publik, veçanërisht ndaj grave në politikë.

Krahasuar me monitorimet e viteve 2022 dhe 2023, GJUD-ja me bazë gjinore ka mbetur në të njëjtat nivele, ndërkohë që përdorimi i GJUD-së ndaj gazetarëve dhe kundërshtarëve politikë ka shënuar rritje të konsiderueshme. Në të njëjtën kohë, përdorimi i GJUD-së ndaj pakicave seksuale, grupeve etnike dhe besimeve fetare ka shënuar rënie. Ndërkaq, janë shfaqur kategori të reja të vëna në shënjestër, si institucionet publike dhe fëmijët/të miturit, duke sugjeruar një shumëllojshmëri të objektivave si përgjigje ndaj zhvillimeve aktuale dhe faktorëve socio-politikë.

Analiza e dukshmërisë tregon se GJUD-ja përhapet me shpejtësi kur riprodhohet fjalë për fjalë në titujt e lajmeve ose në rrjete sociale, duke arritur shpesh te qindra mijëra individë. Mediet me orientim politik e amplifikojnë ose e injorojnë në mënyrë përzgjedhëse përdorimin e GJUD-së duke përforcuar polarizimin dhe duke ulur ndjeshëm mundësinë për llogaridhënie.





RAPORTI I MONITORIMIT MBI GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI



Co-funded by
the European Union



Norway



SMART
Balkans
Civil Society for Shared Society
in the Western Balkans